REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT

Nr. 3098 Prot

Tiranë, më 28/10.2026

NJOFTIM ME SHPALLJE
TË VENDIMIT NR. 2620/1 PROT., DATË 25.09.2026 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË PARAQITURA NGA SHTETASI PTOLEME TALO"

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Ptoleme Talo, me nr. 415 prot., datë 14.02.2025 dhe nr. 415/2 prot., datë 27.06.2025, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së magjistratit E.P., anëtar i Gjykatës së Lartë dhe me vendimin nr. 2620/1 prot., datë 25.09.2026 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të paraqitura nga shtetasi z. Ptoleme Talo", bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", ka vendosur arkivimin e ankesave. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:
- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga "Kongresi i Lushnjës", Pallati 42, H.2, Ap.21", Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË